



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 122

Tiranë – E enjte, 16 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 66/2015 datë 14.7.2015	Për faljen e gjobave për mospagimin në afat të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga subjektet juridike dhe fizike..... 6303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 7.7.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve te Ministria e Zhvillimit Urban, të pronave me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”, “Godina nr. 2 MRP” dhe “Klubi MRP - kati I, i godinës së MRP-së” dhe për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1068, datë 29.12.2010 dhe nr. 250, datë 24.4.2003, të ndryshuar..... 6303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 7.7.2015	Për përdorimin dhe kontrollin e fondeve për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes..... 6311
Vendim i KM nr. 611, datë 7.7.2015	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave..... 6311
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 7.7.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Presidencën..... 6312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 7.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 614, datë 7.7.2015	Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njërive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente..... 6315
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 615, datë 7.7.2015	Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale..... 6319

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 616, datë 7.7.2015	Për shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.....	6332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 7.7.2015	Për disa ndryshime në vendimet nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 7.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 345, datë 24.4.2013, të ndryshuara, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale.....	6338
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 281, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim, të sipërfaqeve të tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i rrugëve hyrëse të projektit të gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”.....	6345
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 7.7.2015	Për shpalljen “Qendër Historike” të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës”.....	6368
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 7.7.2015	Për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar.....	6381



LIGJ
Nr. 66/2015

**PËR FALJEN E GJOBAVE PËR
MOSPAGIMIN NË AFAT TË
KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME
TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SHËNDETËSORE NGA SUBJEKTET
JURIDIKE DHE FIZIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Falen, në masën 100 për qind, gjobat e lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë evidentuar deri më 31 dhjetor 2014, në zbatim të neneve 113, “Mosdeklarimi në afat”, pavarësisht vlerës së detyrimit, dhe 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për subjektet juridike dhe fizike, kur kontributi dhe kamatëvonesa është paguar plotësisht deri në datën 30 shtator 2015.

Neni 2

Gjobat për mosdeklarimin dhe mospagimin në afatet ligjore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 3

Brenda 3 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, administrata tatimore fshin dënimet administrative, të falura sipas këtij ligji, dhe bën pasqyrimet konkrete të fshirjes në regjistrat e saj.

Listat e subjekteve përfituese dhe vlera e gjobave përkatëse publikohen, brenda 3 muajve, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 4

Gjobat që janë në proces apelimi administrativ apo në proces gjyqësor falen, sipas përcaktimeve të nenit 1, të këtij ligji, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 5

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9171, datë 14.7.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bujar Nishani**

VENDIM

Nr. 608, datë 7.7.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
PUNËVE TË BRENDSHME DHE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
BURGJEVE TE MINISTRIA E
ZHVILLIMIT URBAN, TË PRONAVE ME
EMËRTIMIN “DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E BURGJEVE”,
“GODINA NR. 2 MRP” DHE “KLUBI MRP
- KATI I, I GODINËS SË MRP-së” DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1068,
DATË 29.12.2010, DHE NR. 250, DATË
24.4.2003, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve te Ministria e Zhvillimit Urban, të pronës me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, ndodhur në zonën kadastrale 8150, të pronës me emërtimin “Godina nr. 2 MRP”, si



dhe të pronës me emërtimin “Klubi MRP - kati I, i godinës së MRP-së”, sipas formularëve dhe planimetrive bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Prona me emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, ndodhur në zonën kadastrale 8150, prona me emërtimin “Godina nr. 2 MRP”, si dhe prona me emërtimin “Klubi MRP - kati I, i godinës së MRP-së”, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të hiqen nga listat e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, bashkëlidhur vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 1068, datë 29.12.2010, dhe nr. 250, datë 24.4.2003, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Zhvillimit Urban i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe kryeregjistruesi i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Identifikim:							Roland TEGO (Inspektor i Sektorit te Investimeve)			
Supervizori:							Gazment DIBRA (Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Aprovimi:							Bujar NISHANI (Ministri i Drejtësisë) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel./faksa, vula)			
A			B				C			
Nr. Rend.	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa / Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m ² ose m ³	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues	Te dhena te tjera
Indeksi i Hartes								Statusi juridik i perdorimit	Shenime te vecanta	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8150	TR-P-11- P-12	Drejto. e Pergjithshme e Burgjeve Rruga "Abdi TOPTANI"	Truall + Objekte	Rruga "Abdi TOPTANI"	761.8 m ²	Sherbim	Ministria e Drejtësisë	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve	
2		1/243 1/84	TIRANE	Godina e Administrates (2 kat)	Rruga "Abdi TOPTANI"	252 m ²	Sherbim	Ministria e Drejtësisë	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve	
3				Godina e Administrates (1 kat)	Rruga "Abdi TOPTANI"	390.3 m ²	Sherbim	Ministria e Drejtësisë	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve	E Perbashket

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
4				Truall	Rruga "Abdi TOPTANI"	119.5 m ²	Sherbim	Ministria e Drejtësisë	Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve	



3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si kalasa te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror MRP (Ministria e Rendit Publik)

Identifikoi : Grupi I Punes

Bashkia / Komuna Tirane

Shef.Sek.Administrim Prones Y.Myslimaj

Spec. Ing.L. Shkupi Spec. Ing.A. Hallvaxhiu

Supervizoi:

Miratoi : Ministri i Rendit Publik Z. Luan Rama

Fusha e perdorimit te Prones :Ruajtje Rendi



Nr. Rend.	A		Nr.	Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtetirja Gjeografike	B			C			Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
	Zona Kadast Indeks Hartes	Pasuris			Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose ml	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
										Ardhur Me shkresen Nr. Dt.	
			Ministria Rendit Publik								
1				Godina e Ministrise	Bulevardi	1200	Zyra Admin.	MRP	MRP		
2				Post Blloku MRP	Deshmoret e Komb	7	Vend roje	MRP	MRP		
3				Oborri MRP	Nr.3	500		MRP	MRP		
4				Mur rrethues	"	19 ml		MRP	MRP		
5				Godina Nr.2 MRP	Ne krah te M.Transp	696	Zyra Admin.	MRP	MRP		
6				Qendra shendetesor	Rr.Reshit Çollaku	243	Amb.MRP	MRP	MRP		
7				Heliporti	Ish F.Aviacionit	712	Vend qend.H/P	MRP	MRP		
8				Oborri i Heliportit		2130		MRP	MRP		
9				God.sherbimi H/P	"	312	Administrata	MRP	MRP		
10				Laboratori nderlidh.	Rr.Mine Peza	512	Sherb.nderlidhje	MRP	MRP		
11				Arkivi i MRP	Tek In.Qen. Tufine	455	Arkiv	MRP	MRP		
12				Vend Komanda	Bul.Desh.Kombit	1184	Tunel	MRP	MRP		





3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te prona ve ge inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni / Pushtetit Qendror **MRP (Klubi i MRP Tirane)** Identifikimi : Grupi i Punës
Bashkia / Komuna **Tirane** Shef Sek. Administrim Pronës **Y. Myslimaj**
Spec. Ing. L. Shkupi Spec. Ing. A. Halilvaxhiu
Fusha e përdorimit të Pronës **Rruajtje Rendi** Supervizori:
Miratohet : Ministri i Rendit Publik **Z. Luan Rama**

[illegible]







**PLANIMETRI E KATIT TË PARË
EKZISTUESE**



SHK. 1:150








REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

PLANIMETRI E KATIT TË TRETË
SHK. 1:150



EKZISTUESE



**VENDIM****Nr. 610, datë 7.7.2015****PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN
E FONDEVE PËR VEPRIMTARI
SPECIFIKE OPERATIVE TË AGJENCISË
SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË
MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për realizimin e veprimtarive specifike operative, të përdorë fondet për veprimtari specifike operative të miratuara për këtë qëllim.

2. Fondet për veprimtari specifike operative të jenë deri në 25 për qind të buxhetit vjetor të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Fondet për veprimtari specifike operative të përdoren, në vlerë leku dhe në valutë, për:

a) shpenzime për sigurimin e informacionit dhe mbështetjen e veprimtarisë operative;

b) shpenzime për pagesën dhe shpërbimin e burimeve të informacionit;

c) blerje të mallrave, shërbimeve, pajisjeve, mjeteve e programeve, në funksion të veprimtarive specifike operative, si dhe për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar;

ç) marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve, në funksion të veprimtarive specifike operative;

d) shpenzime për takime me përfaqësues të shërbimeve të huaja të inteligjencës, në interes të shkëmbimit të informacionit dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta operative;

dh) shpenzime për trajnime specifike të personelit të strukturave operacionale;

e) shpenzime për kompensimin e familjes së personit që humb jetën për shkak të bashkëpunimit të fshehtë me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Kontrolli financiar për programimin dhe përdorimin e fondeve për veprimtari specifike operative kryhet nga persona të autorizuar, nga:

a) Kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes, të

paktën, një herë në dy vjet;

b) drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të paktën, një herë në vit.

5. Personat e autorizuar nga autoritetet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, për kryerjen e kontrollit të fondeve për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, duhet të jenë të pajisur me certifikatë sigurie personeli të nivelit “Tepër sekret”.

6. Kontrolli të ushtrohet duke respektuar legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”.

7. Vendimi nr. 162, datë 18.3.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin dhe kontrollin e fondit për veprimtaritë specifike të Shërbimit Informativ Ushtarak”, shfuqizohet.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM**Nr. 611, datë 7.7.2015****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj.Irena Beqiraj, komanduar drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Pranvera Fagu (Behushi) emërohet drejtor i Përgjithshëm i Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 612, datë 7.7.2015****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
PËR PRESIDENCËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 10 750 000 (dhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për shpenzime korrente.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Presidenca për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 613, datë 7.7.2015****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 839, DATË 11.12.2003,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 59/2014, datë 12.6.2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin

dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 839, datë 11.12.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Lidhja nr. 1, “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në lidhjen nr. 2, “Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, që përmendet në pikën 3, emërtesat “Pilotët e emëruar në pozicione organike që kërkojnë kryerjen e fluturimeve”; “Pilotët e emëruar në pozicione organike që nuk kërkojnë kryerjen e fluturimeve”; “Personeli mirëmbajtës inxhinieroteknik i aviacionit”; “Personeli fluturues teknik e mekanik.”; “Personeli ushtarak i qendrave të vëzhgimit ajror në Forcat Ajrore” shfuqizohen.

c) Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë fluturues të Forcave të Armatosura të jetë sipas lidhjes nr. 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i të këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2015 dhe fillojnë, përkatësisht:

a) nga data 1 janar 2015, për parashikimin e bërë në pikën 1, shkronja “a”;

b) nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për parashikimin e bërë në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”.

3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 1

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

	Vitet e shërbimit														
OFICERË	Nën 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj. Lejtnant (Admiral)															157000
Gj. Major (Nënadmiral)														147000	150000
Gj. Brigade (Kundëradmiral)													117000	118000	118000
Kolonel (Kapiten i rangut I)											93000	94500	96500	98500	100000
Nënkolonel (Kapiten i rangut II)									74000	75200	76400	77700	78900	80300	81500
Major (Kapiten i rangut III)							58500	59500	60500	61500	63500	64500	65500		
Kapiten (Kapiten lejtnant)				52600	53100	53400	54200	54900	55600	56400	57000				
Toger (Lejtnant)			48600	49900	50800	52100	52600								
Nentoger (Nënlejtnant)	45100	46200	47300	48000	48100	48600									
	Vitet e shërbimit														
NËNOFICERË	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/ Kapter											53500	54500	56200	57300	58300
Kapter								45800	47300	48200	49000	50300	52300		
Rreshter						41000	42300	44500	45800	47300	48200				
Tetar				38500	39200	40100	41000	41500	42500	43500	44500				
Nëntetar	33400	34200	35500	36500	38500	40000									
	Vitet e shërbimit														
USHTARË AKTIVË	1 Vit	2	3	4	5	6	Mbi 6								
Ushtar IV/ Detar IV				35700	37300	37900	38500								
Ushtar III/ Detar III			34600												
Ushtar II/ Detar II	32000	33300													
Ushtar I/ Detar I	30500														
	STUDENTË														
Kadet, rekrut/kandidat për ushtar	Në muaj 3500														



Lidhja nr. 2/1

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët aktivë fluturues të Forcave të Armatosura

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj			
		Në skuadroni dhe grupe të helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjera të Bazës Ajrore Farkë të Forcave të Armatosura	Në strukturat e tjera të Forcave Ajrore	Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura
1.	Pilot	40000	30000	20000	10000
2.	Inxhinier fluturimi	28000	21000	14000	
3.	Mekanik/teknik bordi	24000	18000	12000	
4.	Infermier bordi Operator bordi Vinçier bordi	20000	15000	10000	
5.	Inxhinier avioni/helikopteri	16000	12000	10000	
6.	Kontrollor i trafikut ajror	12000	12000	12000	
7.	Teknik avioni/helikopteri	12000	10000	10000	

**VENDIM****Nr. 614, datë 7.7.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
TË PRIVATIZIMIT TË BANESAVE DHE
OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND
BANESE, ME VENDIME TË
ORGANEVE TË QEVERISJES
VENDORE, NË PRONËSI TË NJËSIVE
TË QEVERISJES VENDORE DHE TË
SHTETIT, KU JANË SISTEMUAR ME
STREHIM BANORË TË PAJISUR ME
AUTORIZIM NGA ORGANET
KOMPETENTE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave që duhen ndjekur për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, për banorët, këtej e tutje “subjekti”, që janë sistemuar me strehim, në bazë të autorizimeve përkatëse, të lëshuara nga organet kompetente.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, për organizimin e punës, të ngrenë strukturën përgjegjëse për shqyrtimin e kërkesave dhe dokumentacionin e depozituar pranë tyre për fillimin e procedurës së privatizimit dhe të përgatitjen e vendimeve për privatizim.

3. Procedura e privatizimit fillon mbi bazën e kërkesës së:

a) subjektit të pajisur me autorizim nga organet kompetente ose, në rast vdekjeje, të trashëgimtarëve të tij; ose

b) të çdo personi të autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar në shkronjën “a”, më sipër.

4. Kërkesa duhet t’i dërgohet me rrugë postare (letër rekomande), brenda 1 (një) viti nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, njësisë së qeverisjes vendore, në territorin administrativ të së cilës ndodhet banesa. Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

a) njësinë e qeverisjes vendore, të cilës i drejtohet;

b) të dhënat personale të subjektit kërkues, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij vendimi;

c) të dhënat në lidhje me banesën ose objektin e kthyer në fond banese, për të cilin kërkohet privatizimi;

ç) datën e kërkesës dhe nënshkrimin e kërkuesit.

5. Kërkesa e depozituar pranë njësisë së qeverisjes vendore duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) autorizimin për strehim, të lëshuar nga organet kompetente;

b) certifikatën e gjendjes familjare të 3 (tre) muajve të fundit;

c) dokumentin e identifikimit të kërkuesit (kartë identiteti dhe/ose pasaportë biometrike).

6. Pas dorëzimit të kërkesës dhe të dokumentacionit, të përcaktuara në pikat 4 e 5, të këtij vendimi, njësia e qeverisjes vendore fillon shqyrtimin e tyre.

7. Për prona që nuk janë në pronësi të njësive së qeverisjes vendore i kërkohet organit shtetëror, që ka pronësinë mbi to, kalimi i së drejtës së pronësisë së pronës, me qëllim privatizimin.

8. Pas marrjes së autorizimit nga organi shtetëror, njësia e qeverisjes vendore vazhdon shqyrtimin e dosjes dhe vendos për:

a) pranimin e kërkesës;

b) refuzimin e kërkesës;

c) kthimin e kërkesës për plotësimin e mangësive në dokumentacion.

9. Plotësimi i mangësive nga subjekti bëhet brenda 15 ditëve, nga data e marrjes së njoftimit nga njësia e qeverisjes vendore. Mosplotësimi i mangësive, brenda afatit të përcaktuar më sipër, sjell refuzimin e kërkesës.

10. Subjekti, i cili nuk depoziton kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikat 4 e 5, të këtij vendimi, apo nuk lidh kontratën e privatizimit brenda afateve të përcaktuara në pikat 4 e 16, të këtij vendimi, humbet të drejtën për të kërkuar privatizimin e banesës në të cilën është strehuar.

11. Për çdo banesë dhe objekt të kthyer në fond banese, për të cilën kërkohet privatizimi, njësia e qeverisjes vendore kryen llogaritjet sipas formularit nr. 2, bazuar në të dhënat e përgjithshme të formularit nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlera totale e privatizimit të banesës llogaritet sipas kësaj formule:



$$V_p = V_b + V_t + V_{sh}$$

V_b - vlera e njësisë së banimit;

V_t - vlera e truallit të vlerësuar;

V_{sh} - vlera e shpenzimeve hipotekare që kryen njësia e qeverisjes vendore për regjistrimin, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP), të njësisë së banimit/banesës.

$$V_b = S_{nj} \times K_n, \text{ ku:}$$

S_{nj} – sipërfaqja e njësisë së banimit;

$K_n = V_n / S_{tot} - \text{kostoja lehtë/m}^2 \text{ e ndërtesës;}$

$V_n = S_{tot} \times (K - V_a) - \text{vlera e ndërtimi të gjithë ndërtesës;}$

S_{tot} – sipërfaqja totale e ndërtimit;

K – kostoja mesatare e ndërtimit e Entit Kombëtar të Banesave, që miratohet çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në shkronjën “dh”, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar.

$V_a = N_v \times (S_{nj} \times K) \times K_o - \text{vlera e amortizimit, ku:}$

N_v – numri i viteve të ndërtimit të ndërtesës;

K_o – koeficienti i amortizimit, që përcaktohet sipas vendimit nr. 401, datë 23.10.1989, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e normave të reja të amortizimit të mallrave e të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit”.

S_{nj} – sipërfaqja e njësisë së banimit;

$$V_t = S_{nj} \times K_t \times C_{st}$$

S_{nj} – sipërfaqja e njësisë së banimit;

$K_t = S_{tottr} / S_{totn} - \text{koeficienti i llogaritjes së sipërfaqes së truallit, ku:}$

S_{tottr} – sipërfaqja nën objekt + sipërfaqen e krijuar nga 1ml (trotuar) gjerësi dhe gjatësi sa perimetri rreth objektit;

S_{totn} – sipërfaqja totale e ndërtimit;

C_{st} – vlera e truallit, e llogaritur duke iu referuar çmimit të shitjes së trojeve, të përcaktuar në vendimin nr. 514, datë 30.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, të miratuar çdo vit.

Ndërsa përcaktimi i kriterëve të shitjes së truallit do të bëhet duke iu referuar vendimit nr. 456, datë 16.4.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes si dhe kriteret e përcaktimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët”. Për përllogaritjen e vlerës së truallit, sipërfaqja e

truallit që privatizohet të mos jetë më e madhe se sipërfaqja e zënë nga ndërtimi plus 1 m trotuar.

12. Kërkesa nënshkruhet edhe nga njësia e qeverisjes vendore dhe mbahet në 3 (tri) kopje identike, prej të cilave:

- një kopje i dorëzohet kërkuarit;

- një kopje kalon me dokumentacionin në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- një kopje vendoset në dosjen e njësisë së qeverisjes vendore.

13. Për çdo ankim, në lidhje me përllogaritjet e kryera në formularët e përcaktuar në këtë vendim, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet, me shkrim, njësisë së qeverisjes vendore. Njësia e qeverisjes vendore ka detyrimin t'i kthejë përgjigje, me shkrim, ankuesit, brenda afateve ligjore, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

14. Njësia e qeverisjes vendore, në përfundim të shqyrtimit të dosjes për privatizim, vendos pranimin ose refuzimin e saj.

15. Me marrjen e vendimit për pranimin e dosjes për privatizim, subjekti përfitues ka detyrimin të lidhë kontratën e privatizimit me njësinë e qeverisjes vendore, brenda 1 (një) viti nga data e marrjes së këtij vendimi.

16. Njësia e qeverisjes vendore dhe përfituesi lidhin kontratën e privatizimit, në të cilën përcaktohen:

a) palët nënshkruese të kontratës;

b) vlera e tarifës, që i takon të paguajë përfituesi, e llogaritur sipas pikës 11, të këtij vendimi;

c) mënyra e shlyerjes së vlerës së tarifës;

ç) mënyra e arkëtimit të vlerës së tarifës;

d) të drejtat e detyrimit e palëve dhe sanksionet përkatëse.

17. Kontrata e privatizimit nënshkruhet nga njësia e qeverisjes vendore, në cilësinë e palës që kryen privatizimin, dhe subjekti/subjektet përfituese, sipas nenit 3, të këtij vendimi. Nëse familja nuk paraqitet të lidhë kontratën e privatizimit brenda 2 vjetëve nga regjistrimi i pronës në emër të bashkisë, atëherë banesa mbetet në pronësi të bashkisë, për t'u përdorur për banesë sociale me qira sociale.

18. Vlera totale e privatizimit, e përllogaritur sipas pikës 12, të këtij vendimi, shlyhet nga subjekti përfitues dhe trashëgimtarët e tij, në



mënyrë të menjëhershme ose me këste mujore të barabarta, me afat likuidimi deri në 25 vjet, me 2% interes në vit. Lidhur me formën e pagesës së vlerës së kontratës, pagesë e plotë apo me këste mujore, kjo caktohet rast pas rasti, nga njësia e qeverisjes vendore. Në rastin e shlyerjes me këste mujore, kalimi i pronësisë bëhet pas shlyerjes së kështit të fundit, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

19. Struktura përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës së privatizimit lëshon vërtetimin përkatës, në favor të subjektit përfitues, në përfundim të përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

20. Kontrata e privatizimit bëhet me akt noterial dhe mbahet në 4 (katër) kopje identike, prej të cilave:

- një kopje e mban noteri;
- një kopje i jepet subjektit përfitues;
- një kopje, së bashku me dokumentacionin, i dërgohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- një kopje arkivohet në dosjen e njësisë së qeverisjes vendore.

Shpenzimet noteriale, për lidhjen e kontratës, janë në ngarkim të subjektit që ka aplikuar për privatizimin e banesës.

21. Struktura përgjegjëse për privatizim, e caktuar nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, përgatit dosjen e privatizimit, e cila përmban:

a) kontratën e privatizimit të banesës, të lidhur mes palëve, sipas përcaktimeve të pikave 13 e 14, të këtij vendimi;

b) formularin nr. 1, “Për llogaritjen e treguesve të shitjes së banesës”;

c) formularin nr. 2, “Për llogaritjen e çmimit të banesës që privatizohet”;

ç) planimetrinë e banesës;

d) planvendosjen e objektit;

dh) planin e rievimit të objektit;

e) dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5, të këtij vendimi, së bashku me kërkesën për aplikim.

22. Një kopje e dosjes së privatizimit i dërgohet për regjistrim, nga struktura përgjegjëse e njësisë së qeverisjes vendore, zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për kontratat e privatizimit me këste mujore, të lidhura sipas pikës 18, të këtij vendimi, njësia e qeverisjes vendore lidh me subjektin/subjektet përfituese kontratë shitjeje me rezervë të pronës, deri në shlyerjen e plotë të vlerës së privatizimit dhe shpenzimeve përkatëse.

23. Shumat e arkëtuara nga privatizimi i banesave apo objekteve të kthyera në fond banese të depozitohen në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore që kryen procedurat e privatizimit. Fondet e përfituara nga privatizimi janë fonde të kushtëzuara dhe përdoren nga njësia e qeverisjes vendore për qëllime të strehimit social.

24. Ngarkohen organet e qeverisjes vendore dhe zyrtat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

FORMULARI NR. 1

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE Bashki /Komunë _____
LLOGARITJA E TREGUESVE TË SHITJES SË NJËSISË SË BANIMIT/BANESAVE INDIVIDUALE
BANESËS _____
ADRESA _____

I. SIPËRFAQJA TOTALE E NDËRTIMIT (m²) _____

II. VLERA E NDËRTIMIT TË NDËRTESES (në lekë) _____

a) Sipërfaqja totale e ndërtimit (m²) _____

b) Kosto e ndërtimit lek/m² të EKB-së _____

në fuqi në momentin e kryerjes së vlerësimit _____

c) Vlera e amortizimit _____

SHUMA I (a x b-c) _____

III. KOSTO E NDËRTESES (lekë /m²)

a) Vlera e ndërtimit të ndërtesës (SHUMA I) _____

b) Sipërfaqja totale e ndërtimit (pa sip. totale të bashkëpronësisë) _____

SHUMA II (a/b) _____

IV. LLOGARITJA E KOEFICIENTIT TË SIPËRFAQES SË TRUALLIT

a) Sipërfaqja totale e truallit në bashkëpronësi _____

b) Sipërfaqja totale e ndërtimit të banesës në m² _____**SHUMA III (a/b)** _____

Data e llogaritjes ____/____/_____

Llogaritja u krye nga:

1) _____

2) _____

3) _____

FORMULARI NR. 2

NJËSIA E QEVERISJES VENDORE Bashki /Komunë _____

LLOGARITJA E ÇMIMIT TË NJËSISË SË BANIMIT/BANESËS NR. _____

BANESA _____

BLERËSI _____

I. VLERA NJËSISË SË BANIMIT/ BANESËS

a) Kosto lek/ m² sip. ndërtimi i njësisë së banimit/banesës _____b) Sipërfaqja e ndërtimit të njësisë së banimit/banesës m² _____**SHUMA I (1a x 1b) lekë** _____

II. VLERA E TRUALLIT

a) Koeficienti i llogaritjes së sipërfaqes së truallit _____

b) Sipërfaqja e ndërtimit të njësisë së banimit/banesës (m²) _____c) Çmimi i truallit lekë për m² _____**SHUMA II (2a x 2b x 2c) lekë** _____

III. VLERA PËRGJITHSHME E NJËSISË SË BANIMIT/BANESËS

a) Vlera e njësisë së banimit/banesës (SHUMA I) _____

b) Vlera e truallit (SHUMA II) _____

c) Vlera e shpenzimeve të përgjithshme për regjistrimin në ZRPP _____

SHUMA III (3a + 3b + 3c) lekë _____

Data e llogaritjes ____/____/_____

Llogaritja u krye nga:

1) _____

2) _____

3) _____

**VENDIM****Nr. 615, datë 7.7.2015****PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË
PRONËSISË SË DISA PARCELAVE
NDËRTIMORE NË FAVOR TË
POSEDUESVE TË OBJEKTEVE
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet maksimale, për të cilat miratohet kalimi i të drejtës së pronësisë mbi parcelën e ndërtimit pa leje, të jenë sipas listës emërore dhe evidencës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore dhe sipërfaqja e përgjithshme e truallit, për secilin qark, janë, si më poshtë vijon:

a) Qarku Elbasan, 22 (njëzet e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 502 (katër mijë e pesëqind e dy) m²;

b) Qarku Berat, 22 (njëzet e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 961 (katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) m²;

c) Qarku Vlorë, 33 (tridhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 651 (gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) m²;

ç) Qarku Kukës, 49 (dyzet e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 797 (tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) m².

d) Qarku Shkodër, 97 (nëntëdhjetë e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 38 870 (tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m²;

dh) Qarku Tiranë, 71 (shtatëdhjetë e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 17 260 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) m²;

e) Qarku Korçë, 6 (gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 659 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) m²;

ë) Qarku Dibër, 28 (njëzet e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 333 (tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) m²;

f) Qarku Durrës, 270 (dyqind e shtatëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 105 063 (njëqind e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tre) m²;

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave / Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesit e ndërtimeve pa leje.

4. Zyrtat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, të mos kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE
TË DHËNAT SIPAS LISTËS EMËRORE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË

NR. RENDOR	DREJTORIA	TË DHËNAT E VETËDEKLARUESIT				ZONA KADASTRALE	NR. I PASURISË	SIPËRFAQJA E PARCELËS m²	LLOJ I PRONËSË
		EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	NR. I PROT. TË VETËDEKLARIMIT				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	13
1	ELBASAN	BESIM	BARDHYL	CËRRIKU	508	2070	234/57	458.2	SHTET
2	ELBASAN	ARDIAN	BARDHYL	CËRRIKU	509	2070	234/58	348.1	SHTET
3	ELBASAN	PASHO	MISIR	DRAGOTI	12	1528	115/31	463.4	PRONË E VET + SHTET
4	ELBASAN	AGRON	IZET	GEQA	21335	2924	2/486	52.4	SHTET
	ELBASAN	VALENTINA	TEKI	SELIMOLLARI	21335				
		FATMIR	TEKI	SELIMOLLARI					
	ELBASAN	LEFTER	TEKI	SELIMOLLARI					
5	ELBASAN	REXHEP	ADEM	BAKO	4622	2296	6/8/1	351.4	SHTET
6	ELBASAN	NDRIÇIM	ADEM	BAKO	7881	2296	6/8/2	409.4	SHTET
7	ELBASAN	MERITA	ADEM	BAKO	4625	2296	6/8/3	293.1	SHTET
8	ELBASAN	SANIJE	ADEM	BAKO	4623	2296	6/8/4	249.4	SHTET
9	ELBASAN	LUAN	XHEVIT	HOXHA	441, 19289	1842	9/344	9.7	PRONË E VET + PRONAR
10	ELBASAN	NIKOLIN	ATEM	ZENELI	118	1842	3/133	26.4	SHTET
11	ELBASAN	DURIM	JAHJA	BEQIRI	8180	8522	6/272	1.6	PRONË E VET + PRONAR
							6/273	1.6	
							6/274	3.4	
							6/275	6.3	
12	ELBASAN	IBRAHIM	RAMAZAN	IBRUSHI	2983, 1029	8524	1/419	89.0	SHTET
13	ELBASAN	BARDHUL	GANI	SINA	6393	8525	31/158	53.6	SHTET
14	ELBASAN	AVNI	ISMAIL	DRIZAJ	20961	2924	1/478	290.5	SHTET
15	ELBASAN	ARBEN	MET	KODRALIU	8190	2446	2/200	128.4	SHTET
16	ELBASAN	KUJTIM	JONUS	ÇEKA	2943	8523	30/256	289.3	PRONAR
17	ELBASAN	BEDRI	SKËNSER	ALLUSHI	8236	8524	1/418	300.0	PRONË E VET + SHTET
18	ELBASAN	FATMIR	SHEFQET	LULJA	3576	8524	7/382	168.6	SHTET
19	ELBASAN	ILMI	JONUS	ÇEKA	3950	8526	22/26	302.7	PRONAR
		JONUS	MUSA	ÇEKA					
20	ELBASAN	SKËNDER	BESIM	ABEDINI	3047	8527	6/83	138.0	PRONAR
21	ELBASAN	TOMORR	SHYQYRI	BYCI	3365	3764	132/23	9.4	SHTET
		BLETIN	SHYQYRI	BYCI			132/24	37.4	
		KLODJANA	SHPËTIM	BYCI					
22	ELBASAN	ARTUR	REXHEP	TOPI	5770	2924	4/250	20.9	SHTET
23	BERAT	NEIM	SADIK	ÇILAJ	17	3810	381/35	160.0	SHTET
24	BERAT	ARDIAN	SADIK	ÇILAJ	10	3810	381/36	160.0	SHTET
25	BERAT	ADRIAN	ISLAM	SADO	62	3810	381/37	280.0	SHTET
26	BERAT	FLORENC	SOKRAT	XHINDI	1349	1687	20/42	190.0	SHTET
27	BERAT	SOKRAT	XHEVIT	XHINDI	7	1687	20/43	54.5	SHTET
28	BERAT	SHKËLQIM	SULEJMAN	RASENI	879	2310	11/756	20.0	SHTET
29	BERAT	SOKRAT	THOMA	BUÇKA	732	2918	1503/74	345.0	SHTET
30	BERAT	BEHIJE	RAPUSH	HOXHA	236	2918	1503/75	327.0	SHTET
31	BERAT	ARTUR	SADIK	PIRJA	29	2918	1338/69	260.0	SHTET
32	BERAT	ARLIND	ENVER	DHËMBI	918	2179	636/21	360.0	SHTET
33	BERAT	GURIM	SULO	SELAMI	830	3227	1/149	300.0	SHTET
34	BERAT	Nexhmedin	Hajdar	Duro	278	8501	10/319	18.8	SHTET
		Përparim	Adriatik	Tabaku	1469				
35	BERAT	Nezmi	Kadri	Xherimeja	86	1217	510/42	400.0	SHTET
36	BERAT	Kasrriot	Ali	Xherimeja	84	1217	510/43	400.0	SHTET
37	BERAT	Idajet	Hajdar	Xherimeja	85	1217	510/41	400.0	SHTET
38	BERAT	RAMADAN	MUHAMET	BAHO	83	3032	455/7	211.0	SHTET



39	BERAT	RAMAZAN	KADRI	ISOLLARI	178	3682	5/301	280.0	SHTET
40	BERAT	ADRIAN	ISLAM	SADO	62	3810	381/37	280.0	SHTET
41	BERAT	SAIMIR	GËZIM	PLAKU	7357	3682	445/68	435.0	SHTET
42	BERAT	FATIME	SEFER	GJIK	61	2310	4/332	16.9	SHTET
43	BERAT	ENVER	RAMADAN	HYSENI	749	2310	2/397	68.4	SHTET
44	BERAT	ISLAM	AVDURAMAN	ALUSHI	1364	2310	2/398	54.6	SHTET
45	VLORE	FLORIAN	GEZIM	ORHANAJ	505/1/60	8601	18/952	213.0	SHTET
46	VLORE	AVDI	NOVRUS	XHUF	836/5	8601	35/298	319.0	SHTET
47	VLORE	SKENDER, ASTRIT	VESEL, SKENDO	DEMO	2716/4	8604	20/207	422.0	SHTET
48	VLORE	HASAN	ISUF	SHEHAJ	3024/4	8604	14/199	150.0	SHTET
49	VLORE	PERIKLI	JANI	PAPAJ	1149/4	8604	27/281	285.0	SHTET
50	VLORE	NAILE	SULO	DAUTAJ	1734/5	8605	13/654	373.0	SHTET
51	VLORE	BEJKUSH, XHIEVDIT	TARTAR	METAJ	257/5	8605	36/203	194.0	SHTET
52	VLORE	QAMIL, METI	TARTAR	METAJ	256/5	8605	36/204	223.0	SHTET
53	VLORE	VIKTOR	REFAT	QOSANI	580/5	8605	13/189	300.0	SHTET
54	VLORE	MILITJADH	BELUL	SIMONI	207/5	8605	18/390	341.0	SHTET
55	VLORE	ADEM	TAULLA	KALLANXHIU	1299/5	8605	19/236	227.0	SHTET
56	VLORE	FATMIR	RRAPO	MATAJ	1255/5	8605	12/348	372.0	SHTET
57	VLORE	LUAN	FEJZO	KOCIAJ	418/5	8605	22/257	287.0	SHTET
58	VLORE	RESHAT	HARSHI	BRAHIMAJ	1188/5	8605	12/384	144.0	SHTET
59	VLORE	KOSTANDIN	FADIL	DEMIRI	1547/5	8605	13/98	101.0	SHTET
60	VLORE	FEJZI	DEMIR	ALIAJ	1081/5	8605	12/321	238.0	SHTET
61	VLORE	ASTRIT, EDUARTD	BAKI	GJINI	451/5	8605	31/404	267.0	PRONAR
62	VLORE	FLAMUR	ISLAM	ARAPAJ	31/5	8605	18/207	349.0	SHTET
63	VLORE	ARDJAN	SADUSH	METAJ	1144/4	8605	15/159	436	SHTET
64	VLORE	VASIL	NAZIF	XHAHERAJ	1359/4	8605	18/230	180	SHTET
65	VLORE	IDAJET	XHAHER	DALIPAJ	715/5	8605	18/217	327.0	SHTET
66	VLORE	PETRI	LATIF	LAMAJ	1128/5	8605	12/420	338.0	SHTET
67	VLORE	BESNIK	HAKANI	NAZERAJ	196/5	8605	3/135	258.0	PRONAR
68	VLORE	LUFTAR, SAZAN	QAZIM	QATO	2490/5	8605	8/357	146.0	SHTET
69	VLORE	FETI	AVDULLA	RRAPAJ	2671/4	8605	15/215	186.0	SHTET
70	VLORE	ILIR	HAMET	SHYTI	1803/4	8605	17/157	270.0	SHTET+ PRONAR
71	VLORE	PERPARIM	KAMBER	RUKAJ	559/4	8605	18/399	321.0	SHTET
72	VLORE	ILMI	BILBIL	DEVOLLAJ	1607/4	8605	18/231	324	SHTET
73	VLORE	ISLAM	FEJZI	ZANAJ	2147/4	8605	16/440	324	SHTET
74	VLORE	MALO	BEJO	MEMINAJ	838/4	8605	2/263	215	SHTET
75	VLORE	KAREMAN	FEIM	HAXHIRAJ	1138/4	8605	15/252	379	SHTET
76	VLORE	ISMET	JONUS	MAHMUTAJ	1839/4	8605	15/130	387	SHTET
77	VLORE	FATOS	JASHAR	DULAJ	3818/4	8605	24/365	290	PRONAR
78	KUKËS	DESART	JEMIN	ELEZAJ	619	2315	3/28	356.12	SHTET
79	KUKËS	SHAQIR	ZAİM	TERSALLA	93	2315	15/67	340.0	SHTET
80	KUKËS	YLBER	SHAIP	ALLARAJ	580	2315	19/24/1	6.5	SHTET
		AJET	REFIK	HALILAJ					
		DASHAMIR	SHEMSI	SHEHU					
81	KUKËS	KOZETA	BASHKIM	HALILAJ	131	2315	33/102/1	25.2	SHTET
82	KUKËS	PETRI	HAJDAR	MUJA	817	2315	47/19	308.0	SHTET
83	KUKËS	ABAZ	RRUSTEM	RUSTA	644	2315	47/62	330	SHTET
84	KUKËS	SHPETIM	RAMADAN	KOVAÇI	482	2315	47/138	452.3	SHTET
85	KUKËS	DASHAMIR	BAJRAM	SHEHU	782	2315	47/140	435.0	SHTET
86	KUKËS	ARTUR	SHABAN	TAHIRAJ	39	2315	49/145	152.84	SHTET
		SHAHE	SUBI	TAHIRAJ					
		ELVIRA	SHABAN	TAHIRAJ					
		ARTA	SHABAN	TAHIRAJ					
		EDLIRA	SHABAN	TAHIRAJ					
		FATIME	SHABAN	TAHIRAJ					
87	KUKËS	HASAN	MEHMET	BASHA	399	2315	55/68	206.0	SHTET
88	KUKËS	AGIM	IMER	DEMIRAJ	409	1347	3/59/1	1.6	SHTET
89	KUKËS	DEMUSH	PESH	MULGECI	238	1347	4/147-N5	94.4	SHTET
90	KUKËS	ASTRIT	AVDYL	AHMATI	380	1347	11/161	117.4	SHTET
91	KUKËS	ASTRIT SEBIE	AVDYL SEJDI	AHMATI AHMATI	891	1347	11/157	12.8	SHTET
		ASTRIT SEBIE	AVDYL SEJDI	AHMATI AHMATI					
		BESNIK	MEHMET	MULGECI					
92	KUKËS	ENVER	MAHMUT	ELEZAJ	590	2315	3/23	363.0	SHTET
93	KUKËS	FLORJAN	ISUF	KOVAÇI	6/8	2315	11/108	55.5	SHTET
94	KUKËS	SAMI	MEHDI	CENGU	597	2315	14/45/1	389.9	SHTET
95	KUKËS	SULEJMAN	HYSNI	ELEZAJ	41	2315	20/35	500.0	SHTET
96	KUKËS	ILIAZ	ABDULLAH	BASHA	458	2315	23/222/2	10.1	SHTET
97	KUKËS	ILIAZ	ABDULLAH	BASHA	458	2315	23/222/1	3.3	SHTET
98	KUKËS	SAIMIR	BAKI	ZELA	21	2315	23/248	4.6	SHTET



		FTINETE	LUTFI	ZELA					
99	KUKËS	QEMAL	SADIK	HAZIRAJ	234	2315	24/55	45.1	PRONAR LIGJOR
100	KUKËS	SOKOL	QAZIM	CENAJ	805	2315	28/162	2.0	PRONAR LIGJOR
101	KUKËS	SAMI	HAMDI	CENGU	743	2315	35/113	103.3	SHITET
102	KUKËS	BARDHYL	RRUZHDI	SOPAJ	176	2315	39/118/2	23.2	SHITET
103	KUKËS	LULZIM	XHEMALI	DEMAJ	200	2315	42/196	295.0	SHITET
104	KUKËS	REXHEP	ILJAZ	LALA	364	2315	42/251/1	30.3	SHITET
		FATE	ISMAIL	LALA					
105	KUKËS	KADRI	AHMET	SOKOLI	718	2315	45/70	104.0	SHITET
106	KUKËS	ADEM	RIFAT	GËRMIZI	8/18	2315	47/131	310.81	SHITET
107	KUKËS	XHEMALI	MUS	NERGUTI	397	2315	47/42/2	395.0	SHITET
108	KUKËS	VLADIMIR	BESNIK	DURAKU	240	2315	47/54/2	256.0	SHITET
109	KUKËS	ALTIN	ISUF	KOVAÇI	358	2315	48/104	23.9	SHITET
110	KUKËS	BESNIK	SEF	SYLA	1134	2315	48/48/1	122.4	SHITET
111	KUKËS	JUNIE	REXHEP	HALLAÇI	46	2315	50/283	302.0	SHITET
112	KUKËS	FLAMUR	ASLLAN	DIDA	164	2315	50/284	377.0	SHITET
113	KUKËS	HYSNI	QAMIL	REXHMATI	256	2315	50/285	481.0	SHITET
114	KUKËS	DASHNOR	ARIF	NERGUTI	197	2315	50/286	267.0	SHITET
115	KUKËS	FESTIM	AHMET	DEMAJ	322	2315	50/287	400.0	SHITET
116	KUKËS	ISMAIL	OSMAN	NERGUTI	1432	2315	50/288	281.0	SHITET
117	KUKËS	SELMAN	HALIL	DEMAJ	243	2315	50/289	320.52	SHITET
118	KUKËS	TASIM	IBRAHIM	OMURI	66	2315	50/291	451.8	SHITET
119	KUKËS	NESRET	NEBI	GERMIZI	135	2315	51/253	250.3	SHITET
120	KUKËS	INDRIT	ALUSH	KURTALLARI	518	2315	54/84/1	54.5	SHITET
121	KUKËS	ADMIR	ADEM	DURAKU	247	2315	54/88/2	192.0	SHITET
122	KUKËS	FAIK	HAMIT	STANISHA	89	2315	55/35/1	441.0	SHITET
123	KUKËS	ISAK	OSMAN	SEFERI	357	2315	55/54/1	280.80	SHITET
124	KUKËS	FLLAZE	BEK	ALIAJ	1177	2282	4/28/1	104.7	SHITET
125	KUKËS	SHKELZEN	MALIQ	XHEBEXHIA	150	2282	315/6	168.6	SHITET
126	KUKËS	SERVET	HAJREDIN	MUJA	16	1819	2/281/1	300.0	SHITET
127	SHKODËR	NDOC	DEDË	DEDA	844,175	8592	11/277	273.0	SHITET
128	SHKODËR	MEDI	BEQIR	IVZIKU	503	8597	13/152	440.0	SHITET
129	SHKODËR	NIKOLLE	NDOKE	DEMAJ	1662	8594	10/ 988	500.0	PRONAR+SHITET
130	SHKODËR	ALFRED	ZEF	KRYPCI	683	8593	6/1016	265.0	SHITET
131	SHKODËR	VIKTOR	NDUE	SHEGAJ	22	1495	28/50	400.0	PRONAR
132	SHKODËR	BESIM	DAUT	DRINAZI	442	8593	5/727	131.0	ME PRONAR
133	SHKODËR	PAVLIN	GJERGJ	GESHTENJA	258	8593	10/530	170.0	SHITET/ME PRONAR
134	SHKODËR	DEDË	KOL	KULLA	2215	8592	9/794	44.4	SHITET
135	SHKODËR	COL	BRAHIM	GJONAJ	411	2220	2/305	500.0	SHITET
136	SHKODËR	TONIN	ZEF	MARINAJ	3947	2220	7/232	47.1	SHITET
137	SHKODËR	KIMETE	SAIT	TAFILEJ	2270	8591	9/589	500.0	SHITET
138	SHKODËR	KIMETE	SAIT	TAFILEJ	985	8591	9/590	80.0	SHITET
139	SHKODËR	GJIN	NDOJE	DOÇAJ	1290	8591	15/954	400.0	P.P.V
140	SHKODËR	SALO	HYSEN	BUHAJ	182	1790	109/40	360.0	SHITET
141	SHKODËR	KUJTIM	HYSEN	BUHAJ	183	1790	109/41	360.0	SHITET
142	SHKODËR	HALIL	HYSEN	BUHAJ	184	1790	109/42	360.0	SHITET
143	SHKODËR	XHEM	IDRIZ	BUHAJ	181	1790	109/43	380.0	SHITET
144	SHKODËR	XHEM	IDRIZ	BUHAJ	131	1790	109/44	300.0	SHITET
145	SHKODËR	TAF	RAM	FIKAJ	218	1790	109/45	380.0	SHITET
146	SHKODËR	AGRON	MUHAMET	FACAJ	262	1790	109/47	220.0	SHITET
147	SHKODËR	GJERGJ	KOLE	ZOJZA	66	1790	244/117	430.0	SHITET
148	SHKODËR	TOM	ZEF	ZOJZA	258	1790	244/119	300.0	SHITET
149	SHKODËR	FRAN	GJON	MANI	1384	1790	244/114	400.0	SHITET
150	SHKODËR	KOLE	PJETER	KOLA	21	1790	244/115	400.0	SHITET
151	SHKODËR	PALOK	NDOC	GJEKA	112	1790	117/76	350.0	SHITET
152	SHKODËR	BARDHOSH	SADIK	DAJCAJ	257	1790	109/48	300.0	PRONAR
153	SHKODËR	TONIN	PJETER	NIKA	1390	1790	244/112	380.0	PRONAR
154	SHKODËR	LUIGJ	FRANO	FRANJA	144	1790	244/110	350.0	PRONAR
155	SHKODËR	PASHKË	PJETER	KULLA	863	1105	9/1	500.0	SHITET
156	SHKODËR	ARBEN	XHEMAL	DULI	631	8594	1/787	270.0	PRONAR
157	SHKODËR	ARJAN	SYRRI	GOLEMI	448	8594	3/517	170.0	PRONAR
158	SHKODËR	FATBARDH	REXHEP	TAFILE	1014	8592	8/708	167.4	SHITET
159	SHKODËR	ASTRIT	NURI	KARAKAÇI	755,1641	8591	2/1397	27.4	SHITET
		AHMET							
160	SHKODËR	ÇLIRIM	MUHAMET	TAHIRI	278	8597	16/209	60.0	SHITET?
161	SHKODËR	GJERGJ	PRELE	SHEHU	780	8594	10/999	350.0	SHITET
162	SHKODËR	DOD	GEG	PRENDI	574/467	8598	2/903	120.0	SHITET
163	SHKODËR	PJERIN	KOLE	GJONI	928	8593	11/684	92.3	SHITET
164	SHKODËR	BAHRI	SHERIF	TARAMANI	249	8591	13/641	345.0	SHITET
165	SHKODËR	BERHAN	SALO	SALA	711, 1862	8597	10/226	500.0	SHITET



166	SHKODËR	VIOLETA	SELMAN	CAFI	547	3949	297/3	900.0	SHTET
167	SHKODËR	MUHAMET	ESAT	MEHJA	102	8594	2/1132	52.9	SHTET/DHE PRONAR
168	SHKODËR	LUK	SIMON	LASKU	169/53	8598	2/905	330.0	ME PRONAR
169	SHKODËR	FRAN	MARK	QAFAFIKU	164/42	8598	2/908	300.0	SHTET
170	SHKODËR	DED	MARK	QAFAFIKU	163/41	8598	2/907	300.0	SHTET
171	SHKODËR	LAZER	NDUE	CARA	161/39	8598	2/909	500.0	SHTET
172	SHKODËR	HAXHI	MURAT	DAIJA	353/247	8598	1/337	35.0	SHTET
173	SHKODËR	FRROK	LLESH	KOLA	162/40	8598	2/910	300.0	SHTET
174	SHKODËR	PREND	JAK	NDREKA	292/177	8598	2/914	290.0	ME PRONAR
175	SHKODËR	LAZER	GJOKË	BIBA	127/3	8598	1/339	450.0	SHTET
176	SHKODËR	NIKOLL	NDUE	NDOKAJ	122 ; 123	8598	1/341	430.0	SHTET
177	SHKODËR	NDUE	NIKOLL	NDOKAJ					
177	SHKODËR	ZEF	NDUE	LLESHI	546/439	8598	1/343	380.0	SHTET
178	SHKODËR	VALENTINA	PAULIN	GJINI	178/62	8598	2/917	440.0	SHTET/ME PRONAR
179	SHKODËR	ALEKSANDER	ZEF	PALOKA	412/306	8598	2/916	230.0	SHTET
180	SHKODËR	PETRIT	KOL	MIRASHI	665/557	8598	2/912	500.0	SHTET
181	SHKODËR	GJERGJ	NIKOLLE	VATAJ	455/348	8598	2/911	500.0	SHTET
182	SHKODËR	NDUE	BIB	FRROKU	458/351	8598	1/347	500.0	SHTET
183	SHKODËR	KISHA KATOLIKE "ARQIPESHK VIA			1092	8593	7/544	395.1	SHTET
184	SHKODËR	KISHA KATOLIKE "ARQIPESHK VIA			1093	8593	7/545	37.1	SHTET
185	SHKODËR	KISHA KATOLIKE "ARQIPESHK VIA			1094	8593	7/546	227.5	SHTET
186	SHKODËR	KISHA KATOLIKE "ARQIPESHK VIA			1095	8593	7/547	483.5	SHTET
187	TIRANA 2	TOMSON	RESHAT	REÇI	2101	8230	4/650	45.6	PRONAR
188	TIRANA 2	SERVETE	BAJRAM	KOLAVERI	455	8190	3/618	340.5	SHTET
		ERMIRA	TOFIK	KOLAVERI					
		ERJON	TOFIK	KOLAVERI					
		ARJAN	TOFIK	KOLAVERI					
189	TIRANA 2	MEFAT	GARIP	SHEHU	825	8260	4/297	80.3	PRONAR
190	TIRANA 2	LUTMIRA	PREL	MARKU	1203	8260	5/328	9.0	SHTET
191	TIRANA 2	AGRON	HIQMET	HAJDERI	474	8340	5/1056	55.6	SHTET
192	TIRANA 2	AGRON	HIQMET	HAJDERI	474	8340	5/1054	59.0	SHTET
193	TIRANA 2	REMZI	RAMADAN	FUSHEKATI	627	8270	6/465	4.2	PRONAR
		HIDAJET	NESHIT	ÇOÇOLI					
		BAJRAME	RIZA	BAJRAMI					
		BILAL	BESIM	HIDRI					
		ANESTI	KOÇO	POSTOLI					
194	TIRANA 2	REMZI	RAMADAN	FUSHEKATI	627	8270	6/466	4.2	PRONAR
		HIDAJET	NESHIT	ÇOÇOLI					
		BAJRAME	RIZA	BAJRAMI					
		BILAL	BESIM	HIDRI					
		ANESTI	KOÇO	POSTOLI					
195	TIRANA 2	EDMOND	MEHMET	ZAJMI	341	8180	3/528	13.5	SHTET
196	TIRANA 2	EDMOND	MEHMET	ZAJMI	640	8180	3/529	52.5	PRONAR
197	TIRANA 2	JANAQ	VASIL	RISTANI	6162	8310	8/442	103.0	SHTET
		MARIGLEN	SPIRO	RISTANI					
198	TIRANA 2	BARI	QAZIM	QAMA	650	8370	5/232	91.6	SHTET
199	TIRANA 2	BANORET E KULLES NR. 4A - HAWAI			VKM nr. 439, dt. 02.07.2014 (ME NDRYSHIME)	8260	6/821	456.0	SHTET
